REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA MEMALIAJ

**Nr_____Prot** **Data: ____/____2022**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: " Izolimi i Taracave te Pallateve ne Bashkine Memaliaj"**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT:45261222-6**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2 931 948 (Dy milion nenteqinde e tridhjete e nje mije e nenteqinde e dyzete e tete ) leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Memaliaj** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **2% e vleres se kontrates 58639 pesedhjete e tete mije e gjashteqinde e tridhjete e nente ) leke pa tvsh.**

**Argumentimi**: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**1.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.1.1.**Per te provuar kapacitet financiare dhe ekonomike ,operatori ekonomik duhet te paraqes kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare 2019,2020,2021 ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 40% e fondit limit qe prokurohet..

2.Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipërme. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**2.1.2** Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar

**Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetare I grupit duhet te dorezoj vertetimin leshuar nga Autoriteti perkates.**

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet te *paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.*

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (*shëno bazën ligjore*) , ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**2.2 .4** Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

**a.)** Operatori ekonomik duhet te paraqesi konsistoje ne :Blerjen e materialeve si katrama dhe emulsion dhe ngjitjen e tyre me gaz ne tarace.

**Shtrese lluster cimento 1:2 t=20mm** do te konsistoje ne: Blerjen e reres lare te cimentos, transportin e tyre ne veper. Pergatitjen e llacit dhe vendosjen e tij ne objekt duke rrafshuar me mastar sipas KTZ.

**-**Keto elemente te paraqiten nga OP ekonomik /me kontrate furnizimi me prodhues te licensuar te ketij produkti.

**b)**punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate pese viteve te fundit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se procedurës, ose

**c)** punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tpese viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e kontratës që prokurohet.

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

**2.2.5** Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Aktin e kolaudimit
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim
- Fatura Tatimore

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve, shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt kolaudimi objekti
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- Fatura tatimore

**2.2.6** ***Liçensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:***

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- **NP-2 A, NP-3 A, sipas modelit te MPPT/MTI/MIE etj….**

**sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.**

**2.2.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete certifikata cilesie si me poshte:**

**2.2.7/1** Shoqeria duhet te paraqese Çertifikate te cilesise se punimeve etj **ISO 9001 (e vlefshme),** ne rast bashkimi operatoresh çdo operator duhet te paraqese ISO sipas përqindjes se llojeve dhe sasive te volumeve te punimeve te secilit ne akt marrëveshje/kontrate bashkepunimi.

**2.2.7/2** Shoqeria duhet te paraqese Çertifikate mbi kushtet e sigurise dhe shendetit te punonjesve **ISO 45001 : 2018** (e vlefshme), ne rast bashkimi operatoresh çdo operator duhet te paraqese certifikaten sipas përqindjes se llojeve dhe sasive te volumeve te punimeve te secilit ne akt marrëveshje/kontrate bashkepunimi.

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, të Republikës së Shqipërisë.*

**2.2.8** Një punësim mesatar i të paktën10 (dhjete) punonjesve, për periudhën Gusht 2022- Tetor 2022 të vërtetuar me;

a) List pagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per peridhen Gusht 2022- Tetor 2022

**2.2.9** Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 1 (nje) muaj kalendarike, i cili fillon me dorezimin e sheshit te ndertimit dhe vazhdon per 1 (nje) muaj pa nderpreje normalisht deri ne perfundim, pavarsishte vitit buxhetor. Per sa me siper OE duhet te paraqesi nje deklarate.

**2.2.10 Makineri dhe Pajisje**

Deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik,qe nevojitet per ekzekutimin e kontrates.

| Nr | LLOJI I MAKINERIVE | PRONESIA | SASIA |
|---|---|---|---|
| 1. | Kamion 5 ton vetshkarkues | Ne pronesi ose me qera | 1 Cope |
| 2. | Betoniere | Ne pronesi ose me qera | 2 Cope |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 3. | Skeleri | Ne pronesi ose me qera | 50m2 |

**Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më poshtë i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",* ***duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar,*** *ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

Specifikimet teknike janë vendosur në bazë nenit 36 të ligjit nr.162/2020, "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

***Specifikimet teknike gjenden në DST, në SPE***

**Njesia e Prokurimit**

| | | |
|---|---|---|
| **Kristina Shqipe** | **Jamir Tabaku** | **Xhuvana Kuçi** |